

Kujtesë

## Letrat e luftës të albanologes Edith Durham

Në botimin e fundit të studiuesit Nasho Jorgaqi mbi Fan Nolin "Vepra VI", ku përfshihet i gjithë letërkëmbimi i poliedrikut, letrat që Durham i shkruan Nolit janë një ekspozitë e kohës, i ditëve të saj me shqetësime të vogla e vramendje të mëdha, plane, këshilla dhe shpresa

Edith Durham ishte e pafuqishme, ato ditë të vjeshtës së tretë të 1944. Jeta e saj po prekte fundin. I kishte kapërcyer të '80-t. Ndërsa bombardimet dhe të shtënat ia behnin herë pas herë mbi qiejt e Londrës, Durham mendonte për shqiptarët e saj të dashur. Nuk dihet shumë për dy vitet e saj të fundit në këtë jetë, vite të mbushur me shpresa për lirinë e Shqipërisë, mbushur me korrespondenca, me marrje e dhënie lajmesh rreth vendit që i mori përfundimisht zemrën, tokës së malësorëve të saj të dashur. E lodhur, e moshuar, dhe e trishtuar. Me ankth ndiqte lajmet rreth kapitullimit të Italisë. Ushqente shpresa se gjithçka po merrte fund. Dhe mandej sërish dëshpërim. Në letra e lajme njoftohesh se trupat gjermane po hynin në Shqipëri. Nëse ndjekim korrespondencën e saj me peshkop Fan Nolin, mësojmë deri edhe imtësitë më të vogla e vramendje të saj në këto kohë.

Viti 1943-1944. Në botimin e fundit të studiuesit Nasho Jorgaqi mbi Fan Nolin "Vepra VI", ku përfshihet i gjithë letërkëmbimi i poliedrikut, letrat që Durham i shkruan Nolit janë një ekspozitë e kohës, i ditëve të saj me shqetësime të vogla e vramendje të mëdha, plane, këshilla dhe shpresa.

Një prej letrave më të bukura është ajo e 6 prillit 1943. "...Kam frikë se gaboheni shumë në qoftë se i varni shpresat për shpëtimin e Shqipërisë tek Anglia. Dhe në mënyrë të veçantë në qoftë se shpresoni tek unë. Kam qenë shumë keq me shëndet në qoftë se e krahuj me herën e fundit kur isha në Shqipëri kur pata kënaqësinë t'ju takoja e të dëgjoja mendimet tuaja. Në mos gaboj ishte në 1921. Qysh nga ajo kohë kam qenë 10 herë në klinika kuruese, e sëmurë rëndë dhe dy vjet më parë bëra një operacion të brendshëm. Kam pak fuqi - dhe në të vërtetë jam 80-vjeçare...". Dhe krejt në fund të kësaj letrë shkruan: "Ju më uroni jetë të gjatë. Mos ma thoni atë. Jam e dërrmuar, e lodhur dhe dëshiroj vetëm të shkoj "atje ku të këqijët pushojnë së bëri keq dhe ku të lodhurit janë në paqe". Dhe nuk dua të jetoj dhe ta shoh Shqipërinë të shkatërruar nga plogështia dhe çmenduria e njerëzve të saj".

Durham e ndiente se kishte rënë pre e kurtheve të moshës. Nuk ishte më ajo gruaja energjike, e cila ditën e pushtimit nga Italia me 7 prill 1939, kur ishte 76 vjeç brofi në këmbë dhe doli në një rrugë të Londrës duke mbajtur në duar një pankartë ku shkruhej: "Larg duart nga Shqipëria!"

Në qershor të vitit 1943, sërish i shkruan një letër të gjatë peshkop Nolit. "...më duket se ju në SHBA nuk e dini se ç'do të thotë luftë. Ne të tërë duhet të shkojmë e të marrim racionet tona për shkak të mungesës së shërbimeve. Dhe hajde bëje atë punë, veçanërisht për ata që janë shumë të moshuar për të përballuar punë të rënda... Jam shumë e vjetër dhe e lodhur".



Edi Durham

Por me gjithë lodhjen dhe trillet e moshës, ditën e rënies së Musolinit ishte e lumtur. Në letrën e 27 korrikut 1943 drejtuar po Nolit, shkruan: "Ja tani lajmi i gëzueshëm i rënies së Musolinit!! Çfarë goditje. Dhe kaq papritur. Ai duhet t'i frymëzoje shqiptarët të bëjnë ende përpjekje më të mëdha për të shpëtimin pushtuesin..." Duket kjo ngjarje ia ka ngjallur shpresat se do ta mbërrin ditën e çlirimit. "...ndoshta do të jetoj derisa të shoh paqen, ndonëse disa kohë më parë kjo dukej si e pamundur...". Dhe sërish shpreson. Në letrën e 11 shtatorit 1943 ndër të tjera shkruan: "... më vjen keq që nuk mund të punoj sa duhet tani kur i kam mbushur të tetëdhjetat. Këtë vit jam më e lodhur se sa vjet, po kam shpresë se do ta pres ditën që Shqipërinë ta shoh përsëri të pavarur...". Sidoqoftë, ajo do të tronditej nga sulmet që zhvillonte fronti gjerman. Përshkruan imtësisht tensionin dhe frikën që zgjonin bombardimet e njëpasnjëshme, dhe më shumë trembej për shqiptarët. Në letrën e 23 nëntorit 1943 Durham shkruan: "... Shtatë net sulme ajrore. Asnjë

bombë nuk ka rënë në lagjen tonë dhe megjithëse të shtënat e mitralozave janë shtuar unë nuk shkoj në bodrum. Sapo dëgjohet aeroplani armik, qielli mbushet me drita në kërkim të tij dhe dritat dridhen nga të shtënat. Kështu që është mjaft e vështirë të flesh. Por ka edhe më keq. Kam frikë se mos gjermanët në Shqipëri po bëjnë shkatërrime të mëdha...".

Letra e fundit për vitin 1943, drejtuar Nolit mban datën 29 dhjetor. Në këtë letër, veç falënderimeve për dhuratat që i dërgojnë bashkatdhetarët nga Amerika, Durham shfaq sërish lodhjen dhe ankesat e moshës. "... Tani jam një plakë e vjetër dhe e molisur. Mu para Kërshëndellave pata një ftohje, por jo shumë të keqe. Kështu isha tërësisht e kapitur. Tani po pushoj, por ndihem shumë e vjetër...". Gjatë vitit që pasoi, 1944, Durham i dërgoi edhe dy letra të tjera Fan Nolit. Në letrën e 31 marsit 1944, ajo shkruan: "Mezi e presim fundin e kësaj lufte përbindësia. Shpresoj se ju i keni do miq të fortë amerikanë që do të kujdesen për interesat e shqiptarëve, kur trupat e vëllazëruara do të arrijnë në Shqipëri...". Ndërsa projektonte ditët e fundit të luftës, dhe analizonte marrëdhëniet e fqinjëve, Edith Durham çdo muaj që kalonte e ndjente më të afërt shpresën se do ta mbërrinte ditën kur Shqipëria të ishte sërish e pavarur. Kjo ishte ëndrra e fundit e saj. Ajo s'mundi ta shohë atë ditë. Ajo vdiq në nëntor të vitit 1944, dy javë para se Enver Hoxha të merrte pushtetin. Vdekja e saj ishte një humbje e madhe për Shqipërinë. Edhe pse nuk kishte marrëdhënie të mira me të, Ahmet Zogu, në atë kohë mbreti në ekzil i shqiptarëve shkroi në gazetën "The Times": "...Ajo na dha ne zemrën dhe ajo fitoi zemrat e malësorëve". (E. P.)


## Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universale të Kosovës në Prishtinë u përurua një libër me poezi i Gjekë Marinajt Poezi në të cilën dominon elementi filozofik

Në një botë ku poezia shpesh tingëllon si një mplakje, e rraskapitur dhe si një luftëtare gati e dorëzuar në mbrojtje të pikave të fundit të sensibilitetit letrar, Gjekë Marinaj shpërthen në skenë me tërë shkëlqimin e rinisë, me energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur, ka vlerësuar Frederik Turner, ndërsa, sipas Kadaresë, Gjekë Marinaj dallohet ndër poetët më të mirë të kohës

Ragip Sylaj

Nga shtëpia botuese "Faik Konica" e Prishtinës, këto ditë ka dalë libri i poezisë "Lutje në ditën e tetë të javës" i autorit Gjekë Marinaj (1965), libër që u përurua dje në Bibliotekën Kombëtare dhe Universale të Kosovës në Prishtinë. Librit i prin teksti i Ndue Ukajt, "Logosi i fjalës poetike", ndërsa përmbillet me atë të Ali Jasiqit, "Shpirti i zbardhur që lëshon tinguj". I paraprirë nga poezia programatike "Autoportret i avancuar", lënda e librit është organizuar në ciklet: Mesnatë pa datë në kalendar, Orë dashurie, Lutjet e së dielës, Duart e nënës, Rrëfimi i Rozafës, Sugjerim me zë të ulët, Ailuropada në gjyqin e fjalës, Labirintet e mendimeve të tangunit.

Nazmi Rrahmani lexoi disa nga vlerësimet që ia janë bërë poezisë së këtij autori. "Në një botë ku poezia shpesh tingëllon si një mplakje, e rraskapitur dhe si një luftëtare gati e dorëzuar në mbrojtje të pikave të fundit të sensibilitetit letrar, Gjekë Marinaj shpërthen në skenë me tërë shkëlqimin e rinisë, me energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur" (Frederik Turner). "Gjekë Marinaj dallohet ndër poetët më të mirë të kohës" (Ismail Kadare). Sipas Mujë Buçpapajt, duke eksperimentuar 'një lloj tjetër', poezia Marinajt ka arritur të nxjerrë një model strukturalist të qëndrueshëm, një poezi në të cilën mbi të gjitha dominon elementi filozofik. Gjatë një analizë që i bëri përmbajtjes së librit të Marinajt, ai u ndal te poezitë: "Autoportret i avancuar", "24 Orë dashuri" etj., të cilat, sipas



Gjekë Marinaj

Buçpapajt, janë më të realizuarat në këtë libër.

Sipas Ramdan Musliut, bie në sy sidomos figura e oksimoronit, me të cilën Marinaj ka nxjerrë një titull libri. Edhe Musliu i ka bërë një analizë të gjerë tekstit poetik të librit të Gjekë Marinajt, duke e vlerësuar atë si një model që tejkalon klishetë e poezisë shqipe. Te poezia e Marinajt ai ka shquar shkallën e lartë të abstraksionit poetik, radikalizmin e gjuhës poetike, një plazmim të çuditshëm poetik. Ai dijen e vet dhe formimin intelektual, përfshirë edhe empirikë jetësore ka mundur ta transformojë në poezi.

"Lutja ka qenë çelës për çdo rilindje në historinë e krishterimit (Pol Jongi Ço), si një derdhje e re e shpirtit që e udhëheq botën larg shkatërrimit dhe asgjësimit. Gjuha shpirtërore e lutjes te Marinaj është tjetërsoj; është si njaj Lutja që e zbulon mendjen e Zotit", tha Prend Buzhala. Sipas tij, sikundër që librat hyjnorë përmbajnë kapituj e dashurisë, të tillë kapituj kanë edhe librat poetikë të Marinajt: që na del si dhuntia më e lartë shpirtërore, si përvojë e jetuar dashurie, si dhurim i vetvetes, ashtu sikur ta sugjeron këtë fusha e gjerë kuptimore e referencës ligjërimore poetike.

Sipas Ali D. Jasiqit, Gama e gjerë e frymëzimit dhe e preokupimit të autorit të kësaj përmbledhjeje është mjaft e gjerë dhe e shumëllojshme.

Marinaj është arratisur nga Shqipëria (1990) dhe që atëherë jeton në ShBA. U diplomua në Shkencat e Përgjithshme të Kolegjit Brookhaven në Dallas. Shkollën e Lartë të Arteve dhe Humanitetit e përfundoi në vitin 2002, në Universitetin e Dallasit, në Teksas. Ka mbaruar studimet Master, në Degën e Letërsisë Botërore në UTD. Në ShBA ka marrë disa çmime letrare. Ka botuar shkrime me karakter letrar në shtypin letrar amerikan, ndërkaq, emri i tij është përfshirë në katër antologji poetike amerikane. Është autor i librave "Mos më ik larg" (1995), "Infinit" (2000), "Ana tjetër e pasqyrës" (2003), "Ca gjëra nuk mund të mbeten sekret" (2008) etj.

Me rastin e Ditës së Evropës dhe Dialogut Evropian

## Në Sharr ka filluar "Festivali Rinor 2008"

Meqë ky festival ka karakter garues, në fund të tij do të shpallen grupet dhe individët më të mirë

Të hënën, në Sharr, ka filluar "Festivali Rinor 2008", tashmë tradicional, të cilin e ka organizuar Drejtorati i Arsimit dhe Kulturës, në bashkëpunim me Qendrën Rinore. Ky manifestim, njëherësh, i kushtohet edhe festave të majit, Ditës së Evropës dhe asaj të Dialogut Evropian. Në këtë manifestim kulturor, si zakonisht, do të marrin pjesë grupet muzikore dhe valltarët e shkollave fillore të të dy trevave të kësaj komune.

Festivali ka karakter garues dhe do të zgjasë katër ditë. Sipas zyrtarëve komunalë të kulturës, ky manifestim tradicional synon promovimin e vlerave etnologjike muzikore e kulturore të të dy trevave të kësaj komune, si dhe promovimin e shoqërisë kosovare drejtë integritetit evropiane. Hapjen e tij e kanë bërë, kryetari i KK-së, Salim



Jenuzi e zv. kryesuesi, nga radhët e komunitetit boshnjak-goran, Sabidin Qufta.

Mbështetjen financiare të këtij festivali e kanë ndihmuar edhe CARITAS-i zviceran, Pro Credit

Bank, si dhe donatorë të tjerë. Në përfundim të tij, juria do të shpallë edhe grupet dhe pikat më të mira, të cilat do të shpërblehen.

S. Kryeziu